



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 127, datë 27.10.2022

**PËR**  
**MIRATIMIN E DRAFT MARRËVESHJES SË BASHKË-INVESTIMIT NDËRMJET**  
**FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT DHE BASHKISË DURRËS ME OBJEKT:**  
**"PËR PROJEKTIMIN NDËRTIMIN DHE MENAXHIMIN E PARKIMIT**  
**MULTIFUNKSIONAL PRANË STACIONIT TË TRENIT, DURRËS"**

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 8/1, neni 9, pika 1.2, shkronja "a", pika 1.6 shkronja "a", neni 64 shkronja "a", "b" dhe "gj", Ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit Nr.10 130, datë 11.5.2009 "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit", i ndryshuar, neni 6 pika 2, neni 7 shkronja "dh", Vendimit nr.536, datë 1.05.2008 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Durrës, të Qarkut të Durrësit", dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria Ligjore, dhe Drejtora e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, pranë Bashkisë Durrës, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e draft marrëveshjes së bashkë-investimit ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Durrës me objekt: "Për projektimin ndërtimin dhe menaxhimin e parkimit multifunksional pranë stacionit të trenit, Durrës".

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria Ligjore dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, pranë Bashkisë Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 28.10.2022**



# MARRËVESHJE BASHKË-INVESTIMI

ndërmjet

Fondit Shqiptar të Zhvillimit

dhe

Bashkisë Durrës

Me objekt:

"Për projektimin ndërtimin dhe menaxhimin e parkimit multifunksional pranë Stacionit  
Të Trenit, Durrës"

TIRANË \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2022



Kjo Marrëveshje Bashkëinvestimi lidhet sot më datë \_\_\_/\_\_\_/2022 ndërmjet:

**Fondit Shqiptar të Zhvillimit**, person juridik shqiptar, i regjistruar me vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë Nr.5061, datë 16.06.1993, organizatë jofitmprurëse që funksionon në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 10130 datë 11.5.2009 "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit", i ndryshuar, pajisur me NIPT J62325010Ë dhe adresë në Rrugën "Sami Frashëri", Nr. 10, Tiranë, Shqipëri, i cili këtu e në vijim do të quhet "**FSHZH**", përfaqësuar nga Z. Dritan Agolli, Drejtor Ekzekutiv,

*dhe*

**Bashkisë Durrës**, person juridik publik, që organizohet dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar me seli në adresën sheshi "Liria", 2000 Durres e përfaqësuar nga Znj. Emiriana Sako, Kryetare e Bashkisë.

#### **MEQENËSE:**

- i. Në kuadër të objektivave strategjike të Qeverisë Shqiptare dhe programit të saj, politikën e zhvillimit rajonal dhe kohezionit, siç janë përcaktuar në Ligjin Nr. 102/2020 si dhe rolit të FSHZH në kuadër të po këtij ligji ;
- ii. Në kuadër të Programit Operacional 2022-2028, si dhe Vendimit nr. 225, datë 23.03.2022, të Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, "Për miratimin e detajimit të financimit të brendshëm 2022-2024", është miratuar "Ndërhyrja për ndërtimin e Infrastrukturës së Transportit, Parkimeve, Stacioneve multimodela, moleve, etj";
- iii. Sipas VKM nr.536, datë 1.05.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Durrës, të Qarkut të Durrësit" është miratuar lista e pronave të paluajtshme publike shtetërore në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Durrës.
- iv. Bashkia Durrës nëpërmjet shkresës së protokolluar në FSHZH me Nr. 1730 Prot., datë 15.06.2022, ka kërkuar mbështetjen për financimin e ndërtimit të parkimit multifunksional duke shprehur interes edhe për partneritet me FSHZH-për realizimin e projektit si dhe administrimin dhe menaxhimin e aktivitetit ekonomik që parashikohet të zhvillohet në të;
- v. FSHZH referuar parashikimeve të Ligjit Nr. 102/2020 "Për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin" është promotor i incentivave që gjenerojnë zhvillim ekonomik e social në funksion të së cilës ka krijuar persona juridikë, me qëllim mbështetjen e njësive vendore në menaxhimin dhe rigjenerimin e aseteve publike dhe të aktiviteteve ekonomike të cilët kanë eksperiencë në menaxhimin e aktivitetit ekonomik dhe të parkimeve publike.

- vi. FSHZH ka shprehur dakordësinë për të hyrë në një partneritet me bashkinë Durrës "Për ndërtimin, administrimin, menaxhimin e parkimit multifunksional pranë Stacionit Të Trenit, Durrës".
- vii. FSHZH, ka angazhuar konsulencë për përgatitjen e projektit teknik për parkimin multifunksional pranë Stacionit të Trenit, Durrës".

## **PËR SA MË SIPËR,**

Palët bien dakord të bashkëpunojnë nëpërmjet angazhimeve reciproke për të arritur qëllimet e tyre të përbashkëta si më poshtë vijon:

### **Neni 1 Përkufizime**

- 1.1. **Marrëveshje bashkë-investimi-** ku palët me vullnetin e tyre të lirë angazhohen të sigurojnë realizimin e projektit, respektivisht bashkia Durrës siguron truallin dhe FSHZH siguron financimin e investimit duke marrë pësipër të drejta dhe detyrime, të përcaktuara në këtë marrëveshje.
- 1.2. **“Objekti”** nënkupton, godinën e parkimit multifunksional dhe hapësirat mbështetëse që ndodhen në pjesën jugore të hyrjes së qytetit të Durrësit, përgjatë dy akseve rrugore: rruga “Adria” dhe rruga e “Doganës”, në veri kufizohet me mbikalimin e këmbësoreve që lidh stacionin e trenit me sheshin e traqeteve.
- 1.3. **Aktivitet ekonomik,** i referohet shërbimit të parkimit si dhe cdo shërbimi tjetër multifunksional, me shërbim parësor parkimin.
- 1.4. **Administrimi i pronës** në kuptim të kësaj marrëveshje është ruajtja dhe mirëmbajtja me qëllim rritjen e vlerës ekonomike të saj.
- 1.5. **Menaxhimi i aktivitetit ekonomik** në kuptim të kësaj marrëveshje është e drejta për të menaxhuar aktivitetin ekonomik që do zhvillohet në pronë.

### **Neni 2 Objekti**

Palët bien dakord se objekti i kësaj Marrëveshje është projektimi, ndërtimi, administrimi dhe menaxhimi i parkimit multifunksional pranë Stacionit të Trenit, Durrës. Për realizimin e këtij projekti, bashkia Durrës do të sigurojë truallin, ndërsa FSHZH do të sigurojë financimin e investimit për realizimin e projektit.

### **Neni 3**

#### **Baza ligjore**

Kjo marrëveshje bazohet në:

- 3.1 Ligjin nr.139/2015 për “Vetqeverisjen Vendore”; neni 8/1, neni 9, pika 1.2, shkronja “a”, pika 1.6 shkronja “a”, neni 64 shkronja “a”, “b” dhe “gj”;
- 3.2 Ligji nr 7850 datë 29.7.1994 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar;
- 3.3 Ligji Nr.10 130, datë 11.5.2009 “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, i ndryshuar, neni 6 pika 2, neni 7 shkronja “dh” ;
- 3.4 Vendimi i Këshillit Drejtues nr. 225, datë 23.03.2022, të Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, “Për miratimin e detajimit të financimit të brendshëm 2022-2024” ;
- 3.5 Vendimi i Këshillit Drejtues për miratimin e marrëveshjes së bashkëinvestimit ndërmjet FSHZH dhe Bashkisë Durrës për parkimin multifunksional pranë Stacionit të Trenit, Bashkia Durrës” ;
- 3.6 Vendimi i Këshillit Bashkiak, Durrës për miratimin e marrëveshjes së bashkëinvestimit ndërmjet FSHZH dhe Bashkisë Durrës për parkimin multifunksional pranë Stacionit të Trenit, Bashkia Durrës” ;
- 3.7 Vendimin nr.536, datë 1.05.2008 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Durrës, të Qarkut të Durrësit"

### **Neni 4**

#### **Përshkrimi i objektit**

- 4.1 “Godina e parkimit multifunksional, pranë Stacionit të Trenit” është një objekt në të cilin ndërthuren funksione të ndryshme publike ku qëllimi kryesor është parkimi. Kjo godinë do të ofrojë hapësirë për rreth 400 poste parkimi automjetesh, parkim bicikiletash, njësi dhe hapësira për shërbime. Kati i fundit i objektit do të jetë i mbuluar me panele fotovoltaike që do të shërbejnë për furnizimin me energji alternative të objektit dhe për furnizimin e mjeteve elektrike. Ky objekt me një sipërfaqe totale ndërtimi rreth 15,000 m<sup>2</sup> dhe shrihet përgjatë dy akseve rrugore: rruga “Adria” dhe rruga e “Doganës” dhe në veri kufizohet me mbikalimin e këmbësoreve që lidh stacionin e trenit me sheshin e trageteve.
- 4.2 Gjendja e territorit të synuar për zhvillimin e zonës paraqitet si shesh/ truall, i paasfaltuar dhe pa asnjë funksion të qartë përdorimi, me kohë të pjeshme ai funksionon si parkim automjetesh dhe hapësirë për stacionimin e autobuzëve të linjave jashtë qytetase.

## **Neni 5**

### **Përshkrimi i aktivitetit**

- 5.1 Aktiviteti që do të kryhet në objektin godinë parkimi multifunkcional dhe hapësira mbështetëse tek stacioni i trenit, Durrës do të jetë ofrimi i shërbimit të parkimit dhe shërbimeve multifunkionale me shërbim parësor parkimin.
- 5.2 Aktivitetet do të ofrohen me pagesë dhe/ ose në formë të stimuluar në bazë të marrëveshjeve individuale.
- 5.3 Aktiviteti ekonomik do të jetë në përputhje me objektivat të përcaktuara në koncept idenë zhvillimore.
- 5.4 Të ardhurat e gjeneruara nga aktiviteti ekonomik do të shpërndahen sipas specifikimeve të përcaktuara në nenin 8 të kësaj marrëveshje.

## **Neni 6**

### **Bashkëpronësia**

Pas përfundimit të realizimit të investimit godina e parkimit dhe hapësirat mbështetëse tek stacioni i trenit, Durrës, do të rregjistrohet pranë Agjencisë Shtetërore e Kadastrës në bashkëpronësi të bashkisë Durrës dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit në pjesë të barabarta.

## **Neni 7**

### **Të drejtat dhe detyrimet palëve**

Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka të drejtat dhe detyrimet si më poshtë:

- 7.1 Të sigurojë financimin për projektimin dhe zbatimin e punimeve dhe realizimin e objektit.
- 7.2 Të kryejë prokurimin e projektimit dhe zbatimit të punimeve, shërbimeve të supervizionit dhe kolaudit në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 7.3 Të realizojë projektin e zbatimit dhe punimet për zbatimin e projektit.
- 7.4 Në përfundim të realizimit të investimit të ndjekë procedurat ligjore për rregjistrimin pranë ASHK të objektit sipas pjesëve të bashkëpronësisë të parashikuara në nenin 6.
- 7.5 Palët bien dakord që FSHZH të ushtrojë të drejtën për administrimin dhe menaxhimin e aktivitetit ekonomik për 4 (katër) vitet e para të funksionimit të parkimit multifunkcional dhe mënyra e menaxhimit në vijim nga palët do të jetë sipas parashikimeve të nenit 9 të kësaj marrëveshje.

Bashkia Durrës ka të drejtat dhe detyrimet si më poshtë:

- 7.6 Të sigurojë vendosjen në dispozicion të truallit, me qëllim realizimin e projektit “Godina e Parkimit multifunksional”, në zonën e Stacionit të trenit dhe të garantojë se nuk ka konflikt juridik dhe/ose social që lind nga pronësia mbi sheshin e ndërtimit ku do të zbatohet projekti.
- 7.7 Të realizojë dhe ndjekë, në rast se është e nevojshme, përpara fillimit të punimeve të ndërtimit, procedurat ligjore për marrjen në pronësi edhe të pjesës tjetër të pronës në funksion të realizimit të projektit si dhe të marrë përsipër përgjegjësinë për zgjidhjen e problemeve juridike dhe/ose sociale që lindin nga pronësia mbi truallin dhe çdo lloj problemi tjetër të mundshëm që pengon zbatimin e punimeve.
- 7.8 Të marrë përsipër që në çdo konflikt të mundshëm gjyqësor që rrjedh nga zbatimi i objektit të kësaj marrëveshje, NjVV-ja të futet në pozitën procedurale të të paditurit në vend të FSHZH-së, sipas nenit 184 të K.Pr.C-së si dhe merr përsipër çdo detyrim nga konflikte gjyqësore të lindura nga marrëdhëniet e krijuara ndërmjet Bashkisë dhe palëve të treta, në lidhje me objektin e kësaj marrëveshje bashkëpunimi, duke pranuar se FSHZH apo subjekti përfaqësues i FSHZH nuk do të jetë palë dhe çdo detyrim i ngarkohet Bashkisë.
- 7.9 Të miratojë projektin teknik, objekt i kësaj marrëveshje në mbeshteje të ligjit nr.139/2015, i ndryshuar.
- 7.10 Të miratojë Lejen e Ndërtimit me zhvillues “Bashkia Durrës dhe FSHZH”, duke sjellë përjashtimin e NJVV-së dhe FSHZH-së nga detyrimi për të paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë, në aplikim të nenit 46/3 të ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” ose NjVV-ja duhet të aplikojë pranë KKT-së për të nxjerrë lejen e ndërtimit.
- 7.11 Të sigurojë lirim dhe dorëzimin e sheshit të ndërtimit të projektit shoqërisë zbatuese të punimeve brenda 5 ditëve nga miratimi i lejës së ndërtimit të objektit.
- 7.12 Të mos transferojë detyrimet në një entitet tjetër juridik (person fizik apo juridik) në lidhje me mbarevajtjen për administrimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e këtij investimi.
- 7.13 Asnjë detyrim i mëparshëm i Bashkisë lidhur me objektin e projektit, nuk do të mbartet mbi asetin apo aktivitetin ekonomik të lidhur me të gjatë kohëzgjatjes së kësaj marrëveshje.
- 7.14 Palët bien dakord që Bashkia të ushtrojë të drejtën për menaxhimin e aktivitetit ekonomik për 4 (katër) vjeçar in e dytë të funksionimit të parkimit multifunksional dhe mënyra e menaxhimit në vijim nga palët do të jetë sipas parashikimeve të vendosura në nenin 9 të kësaj marrëveshje.

## **Neni 8**

### **Shpërndarja e fitimit**

- 8.1 Aktiviteti ekonomik që do të zhvillohet në parkimin multifunksional pranë stacionit të trenit në Bashkinë Durrës, do të menaxhohet nga strukturat menaxhuese në varësi të bashkë-investuesve.



- 8.2 Struktura menaxhuese ka detyrimin të përgatisë planin e biznesit të parkimit multifunksional 6 muaj përpara fillimit të menaxhimit të aktivitetit, i cili miratohet nga palët bashkë-investuese.
- 8.3 Fitimi neto nga ky aktivitet ekonomik do të ndahet midis palëve bashkëinvestuese sipas vendimarrjes dhe dakordësisë së tyre në raport 50 përqind me 50 përqind.
- 8.4 Në rastet kur aktiviteti ekonomik do të rezultojë pa fitim, kostot e aktivitetit do të mbulohen nga struktura përgjegjëse për menaxhimin.
- 8.5 Struktura menaxhuese do të administrojë fitimin duke bërë më pas shpërndarjen e tyre tek pala tjetër një herë në vit pas miratimit të pasqyrave financiare vjetore.

## **Neni 9**

### **Menaxhimi i Aktivitetit Ekonomik**

- 9.1 Sikurse parashikohet në nenin 8, palët bien dakord që FSHZH nëpërmjet personave juridikë ku është ortak i vetëm, të ushtrojë të drejtën për menaxhimin e aktivitetit ekonomik të parkimit multifunksional për 3(tre) vitet e para dhe pas këtij afati menaxhimi i aktivitetit ekonomik do të ushtrohet nga Bashkia Durrës nëpërmjet strukturës përgjegjëse për menaxhimin.
- 9.2 Me përfundimin e afatit të menaxhimit nga një strukturë përgjegjëse, palët në marrëveshje midis tyre përcaktojnë menaxhimin e objektit nga struktura që e ka në menaxhim ose kalimin tek struktura përgjegjëse e palës tjetër ose menaxhimi i objektit i jepet një pale të tretë publike apo private.
- 9.3 Struktura përgjegjëse për menaxhimin do të kryejnë menaxhimin e parkimit multifunksional duke garantuar që cilësia dhe standardet e shërbimit të jenë në përputhje me funksionet dhe përcaktimet e planit të biznesit.
- 9.4 Struktura përgjegjëse për menaxhimin e objektit parkim multifunksional është përgjegjëse për funksionimin e shërbimeve në objekt me cilësi dhe në dobi të qytetarëve.
- 9.5 Struktura përgjegjëse për menaxhimin ka përgjegjësinë për ngritjen e një sistemi transparent të monitorimit dhe kontrollit që garanton aksesin e përhershëm nga ana e palëve të kësaj marrëveshje.
- 9.6 Struktura përgjegjëse për menaxhimin do të përgatisë një informacion periodik tre mujor për aktivitetin ekonomik të zhvilluar në objekt dhe do t'ja vërë në dispozicion të dyja palëve.

## **Neni 10**

### **Ndryshime**

Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm me miratimin e ndërsjellë me shkrim të të dy Palëve.

## **Neni 11**

### **Kohëzgjatja**

- 11.1 Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të saj dhe është pa afat.
- 11.2 Kjo Marrëveshje mund të zgjidhet në çdo kohë me marrëveshje të përbashkët të Palëve.
- 11.3 Në rast të zgjidhjes së Marrëveshjes në mënyrë të njëanëshme nga palët, pala që zgjidh marrëveshjen detyrohet ti shpërblejë palës tjetër dëmet e shkaktuara nga kjo zgjidhje.

## **Neni 12**

### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

- 12.1 Bashkia dhe FSHZH do të bëjnë çdo përpjekje për të zgjidhur miqësisht me negociata çdo mosmarrëveshje ose konflikt që mund të kenë midis tyre për çfarë lidhet me këtë Marrëveshje.
- 12.2 Nëse pas tridhjetë ditësh nga fillimi i negociatave informale konflikti nuk zgjidhet, mund të angazhohet një palë e tretë e pavarur për ndërmjetësim. Në rast se edhe pas kësaj konflikti nuk zgjidhet, palët do t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 12.3 Palët e kësaj Marrëveshje njohin dhe pranojnë që çdo gjykim do të bëhet duke u bazuar në kushtet dhe kërkesat e kësaj Marrëveshje.

## **Neni 13**

### **Komunikimi**

- 13.1 Komunikimi midis palëve do të jetë i vlefshëm vetëm kur bëhet me shkrim.
- 13.2 Një njoftim do të jetë i vlefshëm vetëm pasi të ketë mbërritur në destinacionin e tij.



Lexuar dhe Aprovuar:

**Drejtori Ekzekutiv i FSHZH**

**Dritan AGOLLI**

Emër, Mbiemër, Firmë, Vulë

**Kryetari i Bashkisë**

**Emiriana Sako**

Emër, Mbiemër, Firmë, Vulë

**ANEKSI 1: PROJEKT IDE BASHKËLIDHUR**

# PARKU MULTIFUNKSIONAL DURRËS

01.10.2022



## Përmbajtje

### 1 Gjendja ekzistuese

- 1.1 Pozicioni
- 1.2 Aksesit
- 1.3 Zhvillime urbane të së ardhmes

### 2 Koncepti

- 2.1 Programi
- 2.2 Ambicite

### 3 Elemente arkitektonike


- 3.1 Ndërlidhja me qytetin
- 3.2 Qarkullimi në kate
- 3.3 Imazhe 3d
- 3.4 Planvendosje
- 3.5 Plane dhe prerje
- 3.6 Atmosfera

## DURRËS PARK

### Hyrje

Zona në studim ndodhet në një pozicion strategjik, pranë një njëje të rëndësishme ndërbane: midis hyrjes për në qytetin e Durrësit, qendres historike të qytetit, pranë stacionit të trenit, portit dhe terminalit të pasagjerëve. Ndërsa porti dhe ballina detare kanë tashmë një projekt rihvillimi me Marinen e Durrësit, transporti me tren sot është në gjendje të keqe, por parashikohet të shndërrohet në shpejtë në një aset të vlefshëm ndërfidhës. Duke marrë parasysh sa me lart, zona e propozuar ka perspektivën e shndërrimit nga një hapësirë e djerrë në një pikë shkëmbimi mjetelesh e njerezësh, e domosdoshme jo vetëm për lëvizjen rreth saj por dhe për gjithë qytetin. Propozimi në vijim kërkon të shfaqë vizionin e një ndërtese të re, me funksione të ndërtuara midis parkimit, zyrave dhe aktivitetëve të tjera rikrijuese në një hapësirë bashkëkohore të zhytur mes gjelbrajnit, me synimin për tu kthyer në një landmark të qytetit.

## 1.1 Pozicioni



Zona e parast në qytetin e Durrësit pranë Stacionit të Trenit, sot përdoret për qëllime të pakalim privat, dhe prona saj gjendet dhe stacioni autobusor në rrethafshe. Aktualisht, shprehja është i rritur me beton dhe është një risk për qytetin dhe infrastrukturën urbane dhe gjelbrajnit përreth. Hapësira nuk ka misionologji dhe nëllon në degradimin e zonës.



## 2.2 Ambicie

Panelle fotovoltaike




Parkim biçikletash



Fleksibilitet perdorimi




Parkim makinash



Evente muzikore



Ngarkim makinash elektrike



12

## 3. Elemente arkitektonike

Nderhyrjet për të projektuar teksturën urbane, një urë lidhëse për qytetit

Pikë takimi midis aseteve përreth qyteti / porti/ marina/ treni/ autobuzët/autostrada


Integrimi i gjelbërimit në qytet

Projektimi i flukseve të shpejtësive të ndryshme makina/biçikleta/këmbërsorë




## 3.1 Ndërlidhja me qytetin

- akset: makina
- akset: këmbësorë
- akset: biçikletë




15

3.2 Qarkullimi në kate




16




17

3.3 Imazhe 3D




18




19







23



22




21




20






24




25



26

27

### 3.4 Planvendosje




28




### 3.5 Plane dhe prerje


Plani i katit perdhje



Plani i katit te pare




Plani i katit te dyte




30


Plani i katit te trete



Plani i katit te katert




Plani i katit te peshte




31

### 3.6 Atmosfera


Plani i kalit te gjashte




Prekje ne fasaden e pume



Prekje ne fasaden e pume




32



33




34



35



Shënime



36



37



38

39



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 834 prot.  
18

Durrës, më 10.11.2022

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.127 datë 27.10.2022 “Për miratimin e draft marrëveshjes së bashkë–investimit ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Durrës me objekt “Për projektimin ndërtimin dhe menaxhimin e parkimit multifunksional pranë stacionit të trenit Durrës”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**

